



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT  
Përfundimtar**

**PËR**

**MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT  
CIVIL**

**BASHKIA POGRADEÇ**

**Shkurt 2024**

## RAPORT

### **Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Pogradec.**

#### **Hyrje**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes, si dhe të Vendimit nr. 88, datë 01.11.2023 *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në Bashkinë Pogradec”*, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike për administrimin e këtij procesi.

Mënyra e funksionimit të njësive të vetëqeverisjes vendore, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse, janë të rregulluara me ligjin nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*. Sipas këtij ligji, njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë bashkitë dhe qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 6 dhe 65 të këtij ligji, përcaktohet se: *“Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale. Njësitë administrative në territorin e një bashkie, shtrirja e tyre territoriale dhe emri, përcaktohen me ligj”*;

*“Struktura dhe organika e administratës së njësive administrative janë pjesë të strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë”*.

Në rastin konkret, Bashkia Pogradec në përbërje të saj ka dhe njësitë administrative Buçimas, Udenisht, Çerravë, Velçan, Trebinjë, Dardhas dhe Proptisht, të përcaktuar në ligjin nr. 115/2014 *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*. Struktura dhe organika e këtyre njësive administrative, janë pjesë përbërëse e strukturës dhe organikës së administratës së Bashkisë Pogradec.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt u realizua sipas Programit të Mbikëqyrjes nr. 1055/1 prot., datë 1.11.2023, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Pogradec me shkresën nr. 1055/2 prot., datë 1.11.2023

*“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Bashkia Pogradec”*. Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes në datën 6.11.2023.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë realizimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, i përbërë nga inspektorët Zamira Mujali dhe Inesa Cani, nën drejtimin e Drejtorit të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, Luiseda Zhapa, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Pogradec.

Me shkresën nr. 39 prot., datë 12.01.2024 të Komisionerit, projektraporti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje institucionit të mbikëqyrur, duke i lënë 15 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Institucioni i mbikëqyrur pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të mbikëqyrjes me shkresën e tyre nr. 234/1 prot., datë 18.1.2024 *“Dërgohet projektraporti i nënshkruar”* (protokolluar në KMSHC me nr. 39/1 prot., datë 22.1.2024, ka dërguar të nënshkruar projektraportin, pa vërejtje, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes.

Në këto rrethana, duke u konsideruar e plotësuar kërkesa për zbatimin e procedurës në këtë rast, u hartua edhe raporti përfundimtar i mbikëqyrjes

### **Qëllimi i mbikëqyrjes**

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar.

### **Drejtimit e mbikëqyrjes**

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë

aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

2. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
3. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, nëpërmjet konkurrimit dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 22 dhe akteve nënligjore në lidhje me dy fazat e këtij procesi:
  - verifikimi paraprak nga njësia përgjegjëse, nëse konkurrentët i plotësojnë kërkesat e përgjithëshme dhe të veçanta të vendit të punës;
  - vlerësimi i kandidatëve nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit.
4. Emërimet në shërbimin civil pas përfundimit të procesit të konkurrimit dhe menaxhimi i listës së kandidatëve fitues që kanë arritur pikët, por që nuk janë emëruar. Evidentimi i rasteve të emërimit pa konkurrim, në kundërshtim me kërkesat e nenit 23, të ligjit për nëpunësin civil.
5. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*si janë zbatuar detyrimet e nëpunësit dhe eprorit si dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
6. Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive dhe respektimi i kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 25, të ligjit për nëpunësin civil, gjatë zhvillimit të kësaj procedure nga Komisioni i Brendshëm.
7. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese dhe respektimi i procedurave të kërkuara nga neni 26, i ligjit për nëpunësin civil, nga njësia përgjegjëse dhe Komiteti i Pranimit gjatë zhvillimit të dy fazave të konkurrimit:
  - verifikimit paraprak;
  - vlerësimi i kandidatëve.
8. Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese dhe respektimi i kërkesave të nenit 32, të ligjit për nëpunësin civil nga ana e titullarit të institucionit (*respektimi i kufirit prej 15% të pranimit nga jashtë shërbimit civil*); respektimi i kërkesave ligjore nga ana e njësisë përgjegjëse për

organizimin e konkurrimit dhe respektimi i procedurave të konkurrimit nga ana e Komisionit të Përhershëm të Pranimit, gjatë realizimit të procesit.

9. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

**Aneks i programit:** Aktet administrative, në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për të përfunduar këtë proces:

1. Struktura organizative dhe analitike aktuale e institucionit.
2. Listëprezenca dhe listëpagesa e nëpunësve të institucionit në muajin Tetor 2023.
3. Akti i deklarimit të statusit të nëpunësit civil për shkak të ligjit, për punonjësit aktual të institucionit, nëse ka.
4. Formulari i përshkrimit të punës për çdo pozicion që është përfshirë në procesin e plotësimit të vendeve të lira nëpërmjet pranimit nga jashtë në nivelin ekzekutiv, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë.
5. Materialet që dokumentojnë procesin e rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.
  - Plani vjetor i rekrutimit ku të jetë përfshirë edhe nevoja për rekrutim nga jashtë shërbimit civil për pozicionet e ulta dhe të mesme drejtuese (20%) dhe të lartë drejtuese (15%).
  - Shpallja e vendit të lirë (*grup pozicionesh –nivel ekzekutiv/pozicion për ngritje në detyrë -nivel i lartë drejtues/nivel i ulët ose i mesëm drejtues*).
  - Kërkesa dërguar AKPA/shpallja në faqen e internetit të institucionit.
  - Aktet që vërtetojnë respektimin e afateve në shpallje (*sipas aktit nënligjor dhe udhëzimit të DAP*).
  - Aktet që materializojnë përbërjen e Komisionit të Përhershëm të Pranimit - për nivelin ekzekutiv.
  - Aktet që materializojnë procedurat e ndjekura për fazën e verifikimit paraprak:
    - Lëvizje paralele nivel ekzekutiv (*dërgimi për publikim në AKPA*);
    - Lëvizje paralele në nivelin e mesëm dhe të ulët (*dërgimi për publikim në SHKP*);
    - Lista e kandidatëve të skualifikuar – arsyet dhe komunikimi me ta;
    - Ankimimi;

- Aktet që materializojnë procesin e pranimit në shërbimin civil:
  - verifikimi paraprak/verifikimi përfundimtar mbas ankimimit *(nëse ka dhe dërgimi për publikim)* në nivel ekzekutiv;
  - procesverbli i prezencës në testimin me shkrim;
  - hartimi i tezës nga KPP /sekretimi;
  - procesverbali i prezencës në intervistën me gojë;
  - verifikimi i përgjigjeve të dhëna nga kandidatët e kualifikuar për testimin me shkrim; pyetjet e përzgjedhura nga KPP për këtë fazë;
  - pyetjet e intervistes me gojë;
  - deklarata e rregjistrimit audio;
  - deklarata e paanësisë së KPP;
  - raporti i KPP për rezultatet *(para ankesave)*;
  - vendimi për rezultatin përfundimtar të kandidatit fitues;
  - shpallja e fituesit në AKPA;
  - deklarata e pranimit të pozicionit – rregjistrimi në listën e fituesve të atyre që nuk pranojnë pozicionin;
  - procedura e ankimimit nëse ka;
  
- Aktet që materializojnë procesin e ngritjes në detyrë:
  - akti që materializon ngritjen e Komitetit të Pranimit;
  - verifikimi paraprak/verifikimi përfundimtar mbas ankimimit *(nëse ka dhe dërgimi për publikim)*;
  - procesverbali i prezencës në testimin me shkrim;
  - hartimi i tezës nga KPND /sekretimi;
  - procesverbali i prezencës në intervistën me gojë;
  - pyetjet e intervistës me gojë;
  - deklarata e rregjistrimit audio;
  - deklarata e paanësisë së KPND;
  - raporti i KPND;
  - vendimi për rezultatin përfundimtar të kandidatit fitues;
  - shpallja e fituesit në AKPA;
  - akti që materializon vendimin për pranimin në shërbimin civil sipas nenit 26/4 *(për 20%)* dhe për pranim në shërbimin civil, në nivelin e lartë drejtues *(për 15 %)*;
  - verifikimi paraprak/verifikimi përfundimtar pas ankimimit *(nëse ka dhe dërgimi për publikim)*;
  - procesverbali i prezencës në testimin me shkrim;
  - hartimi i tezës nga KPND /sekretimi;

- verifikimi i përgjigjeve të dhëna nga kandidatët e kualifikuar për testimin me shkrim sipas pyetjeve të përzgjedhura nga KPP për këtë fazë;
- procesverbali i prezencës në intervistën me gojë;
- pyetjet e intervistës me gojë;
- deklarata e rregjistrimit audio;
- deklarata e paanësisë së KPND;
- raporti i KPND;
- vendimi për rezultatin përfundimtar të kandidatit fitues
- shpallja e fituesit në AKPA;
- akti i emërimit të punonjësve në pozicionin e shërbimit civil

6. Dosjet e personelit dhe regjistri i personelit.

7. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të mbikëqyrjes.

### **Metodologjia e mbikëqyrjes**

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin e dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivën e institucionit, si dhe në sektorin e shërbimeve mbështetëse, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u ndërmorën veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim me Përgjegjësën e Sektorit të Burimeve Njerëzore, \*\*\*\*\*, gjatë të cilit u diskutua mbi qëllimin, programin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej t'i vihej në dispozicion grupit të mbikëqyrjes për verifikim.
- U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës, të miratuar për Bashkinë Pogradec.
- U verifikuan procedurat e pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për periudhën janar 2021 - tetor 2023; dokumentet e administruara në dosjen e personelit që provojnë plotësimin e kërkesave të përgjithshme për

pranimin në shërbimin civil sipas përcaktimeve të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

- U verifikuan të dhënat individuale të çdo nëpunësi civil lidhur me përmbushjen e kërkesave specifike të pozicionit të punës si, niveli i diplomës së studimeve universitare, fusha kryesore e studimeve dhe përvoja në punë e lidhur me e arsimin e lartë që ka çdo nëpunës civil.
- U verifikua ligjshmëria e akteve të deklarimit të statusit të nëpunësit civil, për të gjithë ata nëpunës që e kanë përfituar këtë status sipas parashikimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Të dhënat/gjetjet e konstatuara në lidhje me mënyrën e administrimit të shërbimit civil nga institucioni i mbikëqyrur janë të materializuara në tabelat nr. 1 e nr. 2 dhe procesverbalin e mbikëqyrjes të hartuara nga grupi punës dhe që janë pjesë e këtij raporti.

### **Përmbajtja e Raportit:**

#### **I. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes.**

Bashkia, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999 “*Statusi i nëpunësit civil*” (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pasi në nenin 2 të tij, përcaktohet se ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, organet e qeverisjes vendore janë riorganizuar.

Konkretisht, në nenin 54 të ligjit, ku parashikohen detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, në shkronjën “dh” përcaktohet se, **këshilli bashkiak** miraton buxhetin dhe numrin maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njërive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë.

Ndërsa në nenin 64 të këtij akti ligjor, ku parashikohen detyrat dhe kompetencat e kryetarit të bashkisë, në shkronjën “j”, përcaktohet se, **kryetari i bashkisë**, miraton strukturën, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe



rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nisur nga këto përcaktime ligjore, nga analiza e dokumentacionit që është vënë në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në momentin e mbikëqyrjes, Bashkia Vorë është e organizuar dhe funksionon mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me vendimin nr. 188, datë 11.9.2023, të Kryetarit të Bashkisë Pogradec “*Për miratimin e strukturës, organikës dhe Kategorizimit të pozicioneve të punës të Bashkisë Pogradec, njësive administrative dhe institucioneve në varësi për vitin 2023*”.

Sipas kësaj strukture, **administrata e bashkisë** ka gjithsej **760** pozicione pune, nga të cilat **108** pozicione pune, janë **pjesë e shërbimit civil** dhe në të, janë të përfshira edhe funksionet e njësive administrative që janë në varësi të kësaj bashkie.

Në momentin e kryerjes së verifikimit në institucion rezultojnë të lira **30** pozicione, nga këto, **5** pozicione i përkasin kategorisë *së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues*, ndërsa **25** pozicione *kategorisë ekzekutive*. Sipas komunikimit me njësinë përgjegjëse, pozicionet janë vakante për shkak se, procedurat e konkurrimit të zhvilluara për plotësimin e këtyre pozicioneve janë mbyllur pa fitues, pasi kandidatët nuk kanë arritur të kualifikohen për shkak të rezultatit të pikëve ose nuk ka patur kandidatura të përshtatshme për këto pozicione pune.

**Konkluzion:** Nga sa më sipër, vërehet se, në institucionin e bashkisë ka një numër të lartë të pozicioneve vakante, gjë që sjell anomali në kryerjen e detyrave dhe proceseve të ndryshme administrative, edhe pse nga ana e njësisë përgjegjëse janë bërë përpjekje për marrjen e masave për plotësimin e menjëhershëm të tyre, në mënyrë që të vijojë funksionimi normal i aktivitetit institucional. Shkak, për këtë problematikë paraqitet fakti i mos paraqitjes së kandidatëve (aplikantëve) në konkurs, sidomos për specialitetet e caktuara, të cilat kërkojnë edukim arsimor specifik, duke argumentuar se pengesë është mungesa e burimeve njerëzore në këtë zonë, si dhe paga e ulët që është parashikuar në aktin nënligjor për këto pozicione.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, **pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil** në administratën e Bashkisë Pogradec, paraqiten në këtë raport:

- **Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues - 1 pozicion pune**, që i përket pozicionit të punës “*Sekretar i Përgjithshëm*”.

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues - **6 pozicione pune**, të cilat i përkasin pozicionit “*Drejtor Drejtorie*”.
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues - **19 pozicione pune**, të cilat i përkasin pozicionit “*Përgjegjës Sektori*”.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive - **82 pozicione pune**, të cilat i përkasin pozicionit “*Specialist*”.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, në vijim, në përmbajtjen e këtij raporti, do të analizohen në mënyrë të detajuar procedurat për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

**Konkluzion:** Duke analizuar përmbajtjen strukturës organizative, rezulton se në të parashikohet shprehimisht numri i punonjësve, statusi i tyre i punësimit i ndarë në tre nivele **a)** funksionarë politikë, **b)** nëpunës civilë e **c)** punonjës administrativë; është përcaktuar klasifikimi i pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, sipas nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe kategoria e tyre e pagës.

**II. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.**

***II/1. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.***

Administrimi i shërbimit civil për të gjithë institucionet e administratës shtetërore bazohet në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, detyrë kjo e parashikuar në nenin 18, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Më tej, në mbështetje të kësaj dispozite është miratuar vendimi nr. 108, datë 26.2.2014, i Këshillit të Ministrave “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”, në të cilin janë përcaktuar procedurat e hollësishme për përgatitjen, miratimin, afatin e miratimit dhe mënyrën e bërjes publike të planeve vjetore të punësimit.

Në pikën 4 dhe 13 të këtij akti nënligjor përcaktohet se, çdo institucion i administratës shtetërore, përgatit planin e nevojave të tij për rekrutim në shërbimin civil, për vitin e ardhshëm. Institucionet e pavarura publikojnë vendimet për miratimin e planeve vjetore të

punësimin në protalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, në faqet e tyre zyrtare dhe në stendat për njoftimet publike të institucionit.

Në respektim të afatit të vendosur në pikën 11, të VKM-së nr. 108, datë 26.2.2014, planet vjetore të pranimit në shërbimin civil duhet të miratohen në fillim të çdo viti kalendarik (gjatë periudhës janar- shkurt).

Nga dokumentacioni i këqyrrur për periudhën objekt mbikëqyrjeje, në lidhje me miratimin e këtij plani, rezulton se subjekti i mbikëqyrrur e ka përgatitur planin vjetor të rekrutimit në shërbimin civil, për secilën periudhë të verifikimit (viti 2021, 2022, 2023), brenda afatit të parashikuar në dispozitat si më sipër (brenda muajit shkurt të çdo viti), siç është parashikuar në pikën 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikën 11, të VKM nr. 108, datë 26.2.2014, ku përcaktohet se “Njësitë e qeverisjes vendore dhe çdo institucion i pavarur, jo më vonë se muaji shkurt, miratojnë planet e veta të pranimeve vjetore. Planet vjetore të miratuara sipas kësaj pike publikohen”, si më poshtë:

➤ Plani i Pranimit në Shërbimin Civil, viti 2021.

Me aktin nr. 39, datë 26.2.2021, të Kryetarit “Për miratimin e planit të pranimit në shërbimin civil”, është miratuar plani i rekrutimit për plotësimin e **18** pozicioneve të lira për vitin 2021, të paraqitura si më poshtë:

1. Pozicioni “*Specialist për prokurimet publike dhe monitorimin e kontratave*”, Drejtoria e Çështjeve Juridike Prokurimeve dhe Aseteve, kategoria e pagës IV-a.
2. Pozicioni “*Specialist finance*”, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, kategoria e pagës III-b – 2 pozicione.
3. Pozicioni “*Specialist për llogartije/rakordim për taksat dhe tarifave vendore të biznesit*”, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria e pagës IV-a.
4. Pozicioni “*Specialist topograf*”, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, kategoria e pagës IV-a.
5. Pozicioni “*Specialist për zhvillimin dhe promovimin e turizmit*”, Drejtoria e Turizmit, Kulturës, Muzeut dhe Trashëgimisë Kulturore, kategoria e pagës IV-b.
6. Pozicioni “*Specialist për prokurimet publike dhe monitorimin e kontratave*”, Drejtoria e Çështjeve Juridike Prokurimeve dhe Aseteve, kategoria e pagës IV-a.
7. Pozicioni “*Specialist për muzeun dhe trashëgiminë kulturore*”, Drejtoria e Turizmit, Kulturës, Muzeut dhe Trashëgimisë Kulturore, kategoria e pagës IV-b.
8. Pozicioni “*Specialist për rininë*”, Drejtoria e Turizmit, Kulturës, Muzeut dhe Trashëgimisë Kulturore, kategoria e pagës IV-b – 2 pozicione.
9. Pozicioni “*Specialist për trashëgiminë kulturore*”, Drejtoria e Turizmit, Kulturës, Muzeut dhe Trashëgimisë Kulturore, kategoria e pagës IV-b.

10. Pozicioni “*Specialist për zhvillimin e turizmit*”, Drejtoria e Turizmit, Kulturës, Muzeut dhe Trashëgimisë Kulturore, kategoria e pagës IV-b.
11. Pozicioni “*Specialist i kadastrës urbane dhe kontrollin e zbatimit të lejeve*”, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, kategoria e pagës IV-a.
12. Pozicioni “*Specialist për projektet e infrastrukturës*”, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, kategoria e pagës IV-a
13. Pozicioni “*Specialist për kontrollin e zbatimit të lejeve, projekteve dhe dokumentacionit*”, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, kategoria e pagës IV-a.
14. Pozicioni “*Përgjegjës në Sektorin e Bujqësisë dhe Trajtimit të Titujve të Pronësisë*”, Drejtoria e Mbrojtjes së Tokës dhe Koordinimit me Nj. A, kategoria e pagës III-a/1.
15. Pozicioni “*Përgjegjës në Sektorin e Turizmit, Muzeut e Trashëgimisë Kulturore*”, Drejtoria e Turizmit, Kulturës, Rinisë, Muzeut dhe Trashëgimisë Kulturore, kategoria e pagës III-b.
16. Pozicioni “*Specialist finance*”, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, kategoria e pagës III-b.

Më tej, me Vendimin nr. 142, datë 28.06.2021 “*Për një ndryshim në vendimin nr. 39, datë 26.06.2021 “Për miratimin e planit të pranimin në shërbimin civil*”, është shtuar një procedurë konkurrimi: pozicioni “*Përgjegjës i Sektorit të Turizmit, Muzeut dhe Trashëgimisë Kulturore*” për shkak se është krijuar i lirë, duke qenë se nëpunësi që kryente këtë detyrë, pas konkurrimit, ka kaluar në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Bujqësisë dhe Trajtimit të Titujve të Pronësisë*”.

➤ Plani i Pranimin në Shërbimin Civil, viti 2022

Me aktin nr. 47, datë 28.2.2022, të Kryetarit, “*Për miratimin e planit të pranimin në shërbimin civil*”, është miratuar plani i rekrutimit për plotësimin e **30** pozicioneve të lira për vitin 2022, të paraqitura si më poshtë:

1. Pozicioni “*Sekretar i Përgjithshëm*”, kategoria I-b.
2. Pozicioni “*Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore*”, kategoria II-b.
3. Pozicioni “*Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*”, kategoria e pagës II-b.
4. Pozicioni “*Përgjegjës në Sektorin e Planifikimit Urban dhe Projektimit*”, Drejtoria e Planifikimit të Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, kategoria e pages III-b.
5. Pozicioni “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale*”, kategoria e pagës II-b.

6. Pozicioni “Përgjegjës në Sektorin e Asistencës Ligjore dhe Ankimeve Gjyqësore”, Drejtoria e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve, kategoria e pagës III-a/1.
7. Pozicioni “Përgjegjës në Sektorin e Transporteve & Supervizimit të Shërbimeve”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, kategoria e pagës III-a/1.
8. Pozicioni “Përgjegjës në Sektorin e Përfshirjes Sociale, Barazisë Gjinore dhe Mbrojtjes së Fëmijëve”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, kategoria e pagës III-b.
9. Pozicioni “Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria e pagës III-a/1.
10. Pozicioni “Drejtor në Drejtorinë e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve”, kategoria e pages II-b.
11. Pozicioni “Specialist për administimin e asetëve dhe statistikës”, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, kategoria e pagës IV-a.
12. Pozicioni “Përgjegjës në Sektorin e Rinisë”, Drejtoria e Turizmit Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë, kategoria e pagës III-b.
13. Pozicioni “Drejtor në Drejtorinë e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë”, kategoria e pagës II-b.
14. Pozicioni “Specialist për Rininë”, Drejtoria e Turizmit Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë, kategoria e pagës IV-a.
15. Pozicioni “Specialist për Rininë”, Drejtoria e Turizmit Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë, kategoria e pagës IV-a.
16. Pozicioni “Specialist për prokurimet publike”, Drejtoria e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve, kategoria e pagës IV-a.
17. Pozicioni “Përgjegjës në Sektorin e Vlerësimit dhe Regjistrimit”, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria e pagës III-b.
18. Pozicioni “Specialist për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit Rom dhe Egjiptian”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, kategoria e pagës IV-a.
19. Pozicioni “Përgjegjës në Sektorin e Strehimit”, Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative kategoria e pagës III-b.
20. Pozicioni “Specialist për Auditimin e Brendshëm”, Sektori i Auditimit, kategoria e pagës IV-a.
21. Pozicioni “Specialist finance”, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, kategoria e pagës III-b.
22. Pozicioni “Specialist për kontrollin e dokumentacionit dhe shqyrtimin e aplikimeve në sistem E-Leje”, kategoria e pagës IV-a.
23. Pozicioni “Specialist për Strehimin”, Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative, kategoria e pagës IV-a.

24. Pozicioni “*Specialist për emergjencat civile*”, Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative, kategoria e pagës IV-a.
25. Pozicioni “*Inspektor për Mbrojtjen e Konsumatorit*”, Drejtoria e Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit, kategoria e pagës IV-a.
26. Pozicioni “*Jurist*”, Drejtoria e Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit, kategoria e pagës III-b.
27. Pozicioni “*Specialist për Koordinimin e Integritit European dhe Ndhmës së Huaj*”, Njësia për Koordinimin e Integritit European dhe Ndhmës së Huaj, kategoria e pagës IV-a.
28. Pozicioni “*Specialist finance*”, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, kategoria e pagës III-b.
29. Pozicioni “*Specialist për titujt e pronësisë në Nj. Administrative Udënisht*”, Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative, kategoria e pagës IV-a.
30. Pozicioni “*Specialist për supervizim shërbimesh*”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, kategoria e pagës IV-a.

Më pas, me Vendimin nr. 132, datë 6.7.2022 “*Për një ndryshim në vendimin nr. 47 datë 28.02.2022 “Për miratimin e planit të pranimit në shërbimin civil”*”, janë shtuar **2** procedura konkurrimi për plotësimin e pozicioneve:

1. “*Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse*” dhe
2. “*Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Administrative*”,

për shkak se nëpunësit që kryenin këto detyra, kanë konkurruar dhe kanë kaluar në pozicione të tjera, përkatësisht në pozicionet: “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale*” dhe “*Përgjegjës në Sektorin e Përfshirjes Sociale, Barazisë Gjimore dhe Mbrojtjes së Fëmijëve*”.

Më tej, me Vendimin nr. 154, datë 6.9.2022 “*Shtesa në planin vjetor të pranimit të vitin 2022*”, për të njejtën arsye (krijimin rishtas të pozicioneve të lira) është bërë shtesë në planin vjetor me **3** pozicione, të pasqyruara si më poshtë:

1. “*Përgjegjës në Sektorin e Vlerësimit dhe Rregjistrimit*”;
2. “*Specialist për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit Rom dhe Egjiptian*”;
3. “*Specialist për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe çështjeve administrative*”.

➤ Plani i Pranimit në Shërbimin Civil, viti 2023.

Për vitin 2023, me aktin nr. 29, datë 17.2.2023, të Kryetarit “Për miratimin e Planit të pranimit në shërbimin civil”, është miratuar plani i rekrutimit për plotësimin e 20 pozicioneve të lira, të paraqitura si më poshtë:

1. Pozicioni “Sekretar i Përgjithshëm”, kategoria e pagës I-b.
2. Pozicioni “Drejtor i Drejtorisë të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse”, kategoria e pagës II-b.
3. Pozicioni “Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, kategoria e pagës II-b.
4. Pozicioni “Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve”, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve, kategoria e pagës III-b.
5. Pozicioni “Përgjegjës i Sektorit të Transporteve dhe Supervizimit të Shërbimeve”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, kategoria e pagës III-b.
6. Pozicioni “Specialist finance”, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, kategoria e pagës III-b.
7. Pozicioni “Specialist për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe çështjeve administrative”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria e pagës IV-a.
8. Pozicioni “Specialist për prokurimet publike”, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve, kategoria e pagës IV-a.
9. Pozicioni “Specialist për projektet e infrastrukturës dhe planifikimin e territorit”, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, kategoria e pagës IV-a.
10. Pozicioni “Specialist topograf”, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, kategoria e pagës IV-a (2 pozicione).
11. Pozicioni “Specialist për kontrollin e dokumentacionit dhe shqyrtimin e aplikimeve në sistem E-Leje”, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, kategoria e pagës IV-a.
12. Pozicioni “Specialist për projektet e infrastrukturës”, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, kategoria e pagës IV-a.
13. Pozicioni “Specialist i kadastrës urbane dhe kontrollin e zbatimit të lejeve/projekteve”, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, kategoria e pagës IV-a.
14. Pozicioni “Specialist për monitorimin dhe zbatimin e kushteve të kontratës, lejeve të ndërtimit dhe shpronësimeve”, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, kategoria e pagës IV-a.
15. Pozicioni “Specialist për titujt e pronësisë në Nj.A Proptisht”, kategoria e pagës IV-a.

16. Pozicioni “*Specialist per migracionin dhe diasporën*”, Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë, kategoria e pagës IV-a.
17. Pozicioni “*Specialist për zhvillimin dhe promovimin e turizmit*”, Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë, kategoria e pagës IV-a.
18. Pozicioni “*Specialist për supervizim shërbimesh*”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, kategoria e pagës IV-a (2 pozicione).

Referuar të dhënave të administruara në institucion, deri në momentin e mbikëqyrjes në institucion janë plotësuar me procedura konkurrimi vetëm **5** pozicione të planifikuara:

1. Pozicioni “*Sekretar i Përgjithshëm*”, kategoria e pagës I-b.
2. Pozicioni “*Specialist finance*”, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar. kategoria e pagës III-b.
3. **Dy** nëpunës në pozicione “*Specialist për Supervizim Shërbimesh*”, Drejtoria e Turizmit Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë, kategoria e pagës IV-a.
4. Pozicioni “*Specialist për prokurimet publike*”, Drejtoria e Çështjeve Jurdike Prokurimeve dhe Aseteve, kategoria e pagës IV-a.

Referuar pozicioneve vakante të evidentuara në planet e pranimi për vitin 2021, 2022 dhe 2023, të planifikuara për t’u plotësuar përmes procedurave të konkurrimit konstatohet se, në institucionin e mbikëqyrur janë zhvilluar gjithsej **46** procedura konkurrimi, dy prej të cilave kanë përfunduar pa fitues për vitin 2022 dhe janë plotësuar në vitin 2023, bëhet fjalë për pozicionet: “*Sekretar i Përgjithshëm*” dhe “*Specialist për supervizim shërbimesh*”. Ndërkohë, deri në momentin e mbikëqyrjes në institucion, nga **18** procedura të parashikuara gjatë vitit 2023 (për **20** pozicione të lira), janë bërë vetëm **4** procedura konkurrimi, nëpërmjet të cilave kanë dalë fitues dhe janë emëruar **5** nëpunës civilë.

Gjithsej, me anë të konkurrimit janë plotësuar **41** pozicione pune (**29** emërimë në kategorinë ekzekutive, **7** emërimë në kategorinë e ulët drejtuese, **4** emërimë në kategorinë e mesme drejtuese dhe **1** emërim në kategorinë e lartë drejtuese me pranim nga jashtë shërbimit civil).

Në bazë të përcaktimeve të pikës 13, të VKM nr. 108, datë 26.2.2014, në të gjitha rastet, vendimi për miratimin e planit vjetor të punësimit, është publikuar në portalin “*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*”, si dhe në faqen e internetit të institucionit.

**Konstatim:** Nga ana e institucionit të mbikëqyrur plani vjetor i pranimi në shërbimin civil është hartuar dhe miratuar brenda afatit të përcaktuar, duke marrë në konsideratë të gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në parashikimet e nenit 18, të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, dhe Vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil*”.



Gjithashtu, pozicionet e lira janë grupuar sipas kategorisë dhe kriterëve të pozicioneve të punës dhe më pas procedurat e konkurrimeve janë kryer në grup pozicionesh. Pothuaj të gjitha procedurat e konkurrimit janë zhvilluar me më shumë se 1 kandidat pjesëmarrës.

Ndërkohë, nisur nga fakti që, për vite procedura për plotësimin e pozicionit të nivelit të lartë drejtues “Sekretar i Përgjithshëm” në Bashkinë Pogradec, është mbyllur pa asnjë kandidat, për vitin 2023 është hapur procedura e pranimit nga jashtë shërbimit civil, e parashikuar në nenin 32, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND”. Në këtë rast, Komisioneri konstatoi se, nuk është miratuar vendimi “Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e lartë drejtuese për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil”, nga ana e titullarit të institucionit (trajtuar në paragrafin II.4.).

## ***II/2. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv nëpërmjet konkurrimit.***

Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, rregullohet nga ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (kreu IV “Pranimi në shërbimin civil”, nenet 20, 21, 22, 23 e 25); Vendimi nr. 243, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr. 2, datë 27.3.2015, i Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur” (kreu III “Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive”).

Këto dispozita ligjore përcaktojnë rregullat procedurale të konkurrimit, për plotësimin e pozicioneve të punës në nivelin ekzekutiv, sipas të cilave, fillimisht organizohet procedura e lëvizjes paralele e më pas, nëse mbeten pozicione të lira, pas aplikimit të procedurës së lëvizjes paralele, njësia përgjegjëse, i plotëson ato me anën e procedurës për pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

Në pikën 2, të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në pikën 2, të kreut II, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, është përcaktuar se, konkurrimi organizohet në mënyrë periodike nga njësia përgjegjëse, si për grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe për grupin e pozicioneve të administrimit

të posaçëm. Njësitë përgjegjëse në institucionet e vetëqeverisjes vendore organizojnë procedurën për institucionet respektive.

### ***II.2/a. Procedura e lëvizjes paralele në kategorinë ekzekutive.***

Plotësimi i pozicioneve të lira në kategorinë ekzekutive, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, evidentohet në 3 pozicionet e paraqitura më poshtë:

- “*Specialist për projektet e infrastrukturës dhe planifikimit të territorit*”, në Drejtorinë e Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit;
- “*Specialist për kontrollin dhe zbatimin e lejeve dhe dokumentacionit*”, në Drejtorinë e Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit;
- “*Specialist për rininë*”, në Sektorin e Turizmit.

Në të tre procedurat ka patur nga 1 kandidat, nëpunës civil të së njëjtës kategori (*kandidaturat kryenin detyra brenda institucionit*), që plotësonin kushtet për lëvizjen paralele, si dhe kërkesat e posaçme të vendit të punës, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 25, të ligjit.

Të tre pozicionet janë shpallur në portalin Agjencia Kombëtare i Punësimit dhe Aftësive dhe në faqen e internetit të institucionit të bashkisë, përkatësisht:

- “*Specialist për projektet e infrastrukturës dhe planifikimit të territorit*” dhe “*Specialist për kontrollin dhe zbatimin e lejeve dhe dokumentacionit*”, shpallur në datën 11.05.2021;
- “*Specialist për rininë*” shpallur në datën 06.10.2022.

Në përmbajtjen e shpalljes për konkurrim, për të tre procedurat, janë të përfshira të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 4, të kreut VII, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, siç janë:

- a) pozicioni i punës që është vakant (*emërtesa e pozicionit sipas strukturës dhe organikës në fuqi*);
- b) përshkrimi i përgjithshëm i punës për atë pozicion;
- c) kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët;
- ç) dokumentet që duhet të dorëzohen nga kandidatët dhe mënyra e dorëzimit të tyre;
- d) afati i dorëzimit që është i përcaktuar me datë të saktë kalendarike;

- dh) data e daljes së rezultateve për fazën e verifikimit paraprak të kushteve minimale të procedurës së lëvizjes paralele dhe të përmbushjes së kriterëve specifike të vendit të punës;
- e) fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë;
- f) mënyra e vlerësimit të kandidatëve;
- g) data e daljes së rezultateve të konkurrimit;
- gj) mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Procedura e lëvizjes paralele, sipas pikës 6, kreu VII, të VKM nr.243, datë 18.3.2015, përfshin dy faza:

- a) Verifikimin e kandidatëve, të cilët përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.
- b) Vlerësimin e kandidatëve, ku përfshihen vlerësimi i përvojës në punë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet pozitive dhe intervista e strukturuar me gojë.

Nga këqyrja e materialeve rezulton se, në zbatim të pikave 7, 8, 9 e 10, të kreut VII, të aktit nënligjor, njësia përgjegjëse ka vepruar si më poshtë:

- Ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim,
- Ka bërë njoftimin e verifikimit paraprak (*lista me emrat e kandidatëve*), publikuar në AKPA dhe në faqen e internetit të institucionit,
- Në fazën e verifikimit paraprak nuk ka patur kandidatë të s’kualifikuar.

➤ *Vlerësimi i kandidatëve nga Komisioni i Brendshëm.*

Në bazë të përcaktimeve të pikës 3, të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pikave 12 - 18/1, të kreut VII, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, kandidatët e kualifikuar për të kaluar në fazën e dytë të konkurrimit, vlerësohen nga Komisioni i Brendshëm, i cili bazohet në strukturën e ndarjes së pikëve si më poshtë:

- a) 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë, për përvojën (*10 pikë për tejkalim të lehtë të kërkesave; 15 pikë për tejkalim të kërkesave; 20 pikë për tejkalim domethënës të kërkesave*), 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura

me fushën përkatëse (3 pikë për tejkallim të lehtë të kërkesave; 5 pikë për tejkallim të kërkesave; 10 pikë për tejkallim domethënës të kërkesave), 10 pikë për çertifikimin/vlerësimet më të fundit pozitive (5 pikë për çertifikimin/vlerësimin “mirë”; 10 pikë për çertifikimin/vlerësimin në nivelin “shumë mirë”).

b) 60 pikë intervista me gojë.

Komisioni i Brendshëm, sipas akteve ligjore, ka në përbërje të tij 3 anëtarë:

- a) 1 përfaqësues nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, kur është e mundur, i të njejtit nivel ose i një niveli më të lartë se pozicioni që rekrutohet;
- b) eprorin direkt;
- c) 1 përfaqësues të emëruar nga titullari i institucionit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se është ngritur Komisioni i Brendshëm, për vitin 2021, me Urdhrin nr. 285 datë 24.05.2021, dhe për vitin 2022, komisioni është ngritur me Urdhrin nr. 222, datë 30.11.2022.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, Komisioni i Brendshëm ka vepruar në këtë mënyrë, në lidhje me vlerësimin e kandidatëve:

- ✓ Janë njoftuar kandidatët nëse janë dakord që intervista të regjistrohet; në deklaratat e nënshkruara prej tyre, kandidatët pjesëmarrës nuk kanë pranuar që intervista të regjistrohet.
- ✓ Në përfundim të procedurave të konkurrimit, Komisioni i Brendshëm ka bërë vlerësimin përfundimtar për dokumentacionin e dorëzuar dhe intervistën me gojë, duke vlerësuar kandidatët për secilën procedurë, përkatësisht: \*\*\*\*\* me 84 pikë, \*\*\*\*\* me 84 pikë dhe \*\*\*\*\* me 81 pikë.

Në përfundim të secilës procedurë, është bërë publikimi për shpalljen e fituesit, në portalin AKPA dhe në faqen zyrtare të bashkisë. Më pas njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e emërimit për secilin fitues si më poshtë:

- ✓ \*\*\*\*\*, me aktin nr. 126, datë 01.06.2021, është emëruar në pozicionin, “Specialist për projektet e infrastrukturës dhe planifikimit të territorit”;
- ✓ \*\*\*\*\*, me aktin nr. 125, datë 01.06.2021, është emëruar në pozicionin, “Specialist për kontrollin dhe zbatimin e lejeve dhe dokumentacionit”;
- ✓ \*\*\*\*\*, me aktin nr. 190, datë 01.11.2022, është emëruar në pozicionin, “Specialist për rininë”.

## ***II.2/b. Shpallja e konkurrimit për pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive***

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara, për periudhën objekt mbikëqyrjeje, rezulton se, nga **29** pozicione pune që i përkasin kategorisë ekzekutive, me emërtesën “*Specialist*”, të cilat janë plotësuar nëpërmjet konkurrimit të hapur, **3** pozicione pune janë plotësuar nëpërmjet *lëvizjes paralele*, ndërsa **25** pozicione pune janë plotësuar nëpërmjet *pranimit në shërbimin civil*, dhe **1** rast është përmblyllur me emërim të kandidatit fitues, nga lista e fituesve, brenda kohës së vlefshmërisë së saj.

Komisioneri verifikoi hapat proceduralë që ka ndjekur institucioni i mbikëqyrur, për menaxhimin e procesit të konkurrimit lidhur me plotësimin e vendeve vakante të kategorisë ekzekutive, si dhe respektimi i afateve procedurale të përcaktuara nga ligji dhe aktet nënligjore.

Gjatë zhvillimit të këtyre procedurave, njësia përgjegjëse ka vepruar si më poshtë:

- Në shpalljen e vendit të lirë, është përcaktuar se aplikohet në të njëjtën kohë për të dy procedurat (*lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil*), duke përcaktuar për secilën procedurë afatin e dorëzimit të dokumenteve me datë të saktë kalendarike. Në këtë rast njësia përgjegjëse ka vepruar në përputhje me rregullimet e pikës 1, të nenit 25, të ligjit për nëpunësin civil, ku parashikohet se plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, bëhet së pari nga nëpunës civilë të së njëjtës kategori nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe nëse në përfundim të kësaj procedure nuk ka një fitues, atëherë njësia përgjegjëse organizon procedurën e pranimit në shërbimin civil nëpërmjet konkurrimit të hapur.
- *Shpalljet për vendet e lira* të publikuara në portal dhe në faqen zyrtare të bashkisë, kanë të përfshirë në përmbajtjen e tyre të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën 9, të kreut II, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, si dhe kategorinë/klasën e pagës të pozicionit për të cilin është organizuar konkurrimi.
- *Konkurrimi është shpallur sipas rastit vetëm për një pozicion pune të kategorisë ekzekutive ose për grup pozicionesh* sipas ndarjes që ju bën ligji kësaj kategorie në grupe të administrimit të përgjithshëm dhe grupe të administrimit të posaçëm (*ndarja e parashikuar në pikën 8, të nenit 19, të ligjit*).

Në këtë proces, u verifikua zbatimi i kërkesave të nenit 22, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore, si dhe afatet procedurale të parashikuara në pikën 8 e 10, të kreut II, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, pika 9, kreu II, e VKM nr. 242, datë 18.3.2015, ku përcaktohet se, shpallja e procedurës së pranimit bëhet të paktën 35 ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e

konkurrimit; afati i dorëzimit të dokumentacionit për lëvizje paralele jo më pak se 10 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes; për pranimit në shërbimin civil jo më pak se 15 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes.

Nga verifikimi rezultoi se, sipas përcaktimeve në pikën 2, të kreut IV, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, brenda afatit prej *16 ditë kalendarike* nga data e mbylljes së pranimit të dokumentacionit për të gjitha procedurat e pranimit në shërbimin civil, njësia përgjegjëse ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Duke vijuar më tej, ligji nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka përcaktuar që në rastet kur, për një konkurrim janë shpallur më shumë fitues se sa pozicionet vakante për të cilat është zhvilluar procedura e hapur e konkurrimit, njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 23, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe pikës 18, të kreut IV, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i rendit kandidatët fitues, të cilët nuk janë emëruar për shkak të mungesës së vendeve vakante, *në një listë me vlefshmëri 2- vjeçare*. Nëse gjatë kësaj periudhe njësia përgjegjëse zhvillon një procedurë konkurrimi për të njëjtin grup pozicionesh, kandidatët fitues, të paemëruar ende, rirenditen në listën fituese të konkurrimit përkatës sipas rezultatit përfundimtar.

Pas verifikimit të listës së fituesve, e cila menaxhohet nga njësia përgjegjëse, rezultoi se, fituesja \*\*\*\*\* është emëruar në pozicionin “*Specialist për trashëgiminë kulturore*”.

Gjithashtu, në aktin nënligjor që rregullon fazën e shpalljes së vendit të lirë, është përcaktuar se, “*aplikohet në të njëjtën kohë për të dy procedurat (lëvizje paralele, pranimit në shërbimin civil), duke përcaktuar për secilën procedurë afatin e dorëzimit të dokumenteve me datë të saktë kalendarike*”.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse, ka vepruar në përputhje me rregullimet e pikës 1 dhe 2, të nenit 25, të ligjit për nëpunësin civil, ku parashikohet se, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, bëhet *së pari*, nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, nëse në përfundim të kësaj procedure nuk ka një fitues, atëherë njësia përgjegjëse organizon procedurën e pranimit në shërbimin civil nëpërmjet konkurrimit të hapur.

Legjislacioni kërkon që shpalljet e vendit të lirë të publikuara, të kenë të *përfshirë në pëmbajtjen e tyre të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën 9, të kreut II, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015*, si dhe kategorinë e pagës të pozicionit për të cilin është organizuar konkurrimi.

Në zbatim të nenit 19, pika 8, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pozicionet e nivelit ekzekutiv klasifikohen sipas natyrës së pozicionit, konkretisht në grupet e administrimit të përgjithshëm dhe në grupet e administrimit të posaçëm. Më tej, në kreun II, pika 1, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, përcaktohet se, procedura e pranimit në shërbimin civil, organizohet në mënyrë të ndarë për grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe për çdo grup të pozicioneve të administrimit të posaçëm.

Në këtë rast vërehet se, nga ana e institucionit janë zbatuar kërkesat e pikës 9, duke bërë shpalljen e procedurës së konkurrimit për grup pozicionesh në **16** raste, për të cilat lloji i diplomës që kërkohet dhe kërkesat e posaçme të pozicionit të punës janë të njëjta, ndërsa në **10** raste shpallja e procedurës së konkurrimit është bërë vetëm për një pozicion pune. Në **2** raste procedura e konkurrimit është mbyllur pa fitues dhe bëhet fjalë për pozicionet “Specialist për rininë” në datë 02.09.2022 dhe “Specialist finance” në datë 22.11.2022, për këtë arsye procedurat janë shpallur përsëri në vitin pasardhës (në planin e vitit 2023).

**Konkluzion:** Në të gjitha rastet e shpalljes së vendeve të lira, rezulton se janë zbatuar kërkesat e nenit 22, 23, 24 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, si dhe janë respektuar afatet e parashikuara në pikën 8 e 10, të kreut II, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, si dhe pika 9, Kreu II, e VKM nr. 242, datë 18.3.2015, ku përcaktohet se, shpallja e procedurës së pranimit bëhet të paktën 35 ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e konkurrimit; afati i dorëzimit të dokumentacionit për lëvizje paralele jo më pak se 10 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes; për pranim në shërbimin civil jo më pak se 15 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes.

➤ Krijimi i Komitetit të Përhershëm të Pranimit (KPP) dhe vlerësimi i kandidatëve

Nisur nga përcaktimi i pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe rregullave të përcaktuara në kreun III dhe IV (pikat nga 7 deri në 13), të VKM nr. 243, dt. 18.3.2015, i ndryshuar, kandidatët e kualifikuar për të kaluar në fazën e dytë të konkurrimit, vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP).

Krijimi i KPP, përbërja e tij, si dhe detyrat që duhet të kryejë ky organ, janë të parashikuara në Kreun III dhe IV të VKM nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe ndarjen III/3, III/4, III/5, III/6, III/7 e III/8, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, sipas pikës 3, kreu III, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, përbëhet nga pesë anëtarë:

- a) 1 anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson KPP-në;
- b) 2 anëtarë të zgjedhur nga titullari midis nëpunësve të institucionit, nëse është e mundur të nivelit të mesëm drejtues;
- c) 2 ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit për grupet përkatëse.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, rezulton që, institucioni i mbikëqyrur, me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm ka ngritur KPP-në, me 5 anëtarë (*3 përfaqësues të institucionit dhe 2 ekspertë të jashtëm të fushës së vlerësimit të pozicionit që zhvillohet procedura konkurruese*).

**Konstatohet se**, Komiteti i Përhershëm i Pranimit i ngritur si më sipër, nuk ka funksionuar për të gjitha procedurat e kategorisë ekzekutive, të shpallura përgjatë vitit siç parashikon legjislacioni. Në disa konkurrime ai është ngritur rast pas rasti për procedura të realizuara brenda të njëjtit vit.

Për sa më sipër, sjellim në vëmendje të institucionit që në vijim, duhet të tregojë kujdes në ngritjen dhe kohëzgjatjen e këtij organi. Gjatë vitit të funksionimit të tij, mund të ndryshojë përbërja vetëm në rastet kur paraqitet nevoja e ndryshimit të ekspertëve të fushës që do të kryhet testimi, ose në rast se ndonjeri prej anëtarëve paraqet pengesa ligjore.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se, për kryerjen e vlerësimit me shkrim të kandidatëve, anëtarët e KPP, kanë hartuar testet përkatëse, të cilat janë paraprirë nga procesverbali për përzgjedhjen e pyetjeve, i mbajtur nga anëtarët e KPP. Në të gjitha rastet është hartuar çelësi i përgjigjeve që duhet ta administrojë secili prej anëtarëve të KPP në momentin e zhvillimit të konkurrimit, por nuk është nënshkruar në fund prej tyre.

Testet përmbajnë pyetje me alternativa dhe me shtjellim sipas rregullave të përcaktuara në pikën 2, të ndarjes III/5, të udhëzimit të DAP, brenda fushës së njohurive dhe aftësive mbi të cilat do të zhvillohet testimi, të përfshira në shpalljen për konkurrim, por mungon bashkëlidhur përgjigja e saktë për secilën pyetje.

Anëtarët e KPP kanë korrigjuar testet dhe kanë vlerësuar kandidatët duke dhënë pikët për secilin. Në vlerësimin me shkrim, anëtarët e KPP, kanë zbatuar rregullat e pikës 8, të paragrafit III/6, të udhëzimit të DAP, duke pjestuar shumën totale të pikëve me pesë (në bazë të numrit të vlerësuesve).



**Konkluzion:** Nga verifikimet si më sipër, Komisioneri vlerëson se nga njësia përgjegjëse janë bërë përpjekje që procedurat e rekrutimit nëpërmjet konkurrimit të hapur për kategorisë ekzekutive, të kryhen sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Megjithatë, gjatë realizimit të procedurave të konkurrimit në zbatim të planit vjetor të rekrutimit për vitet 2021-2023 evidentohen mangësi jo të karakterit procedural, por që janë detyrim për tu plotësuar, si:

- Kandidatët konkurrentë ***nuk janë njoftuar për nënshkrimin e deklaratës së pranimit ose mospranimit për të regjistruar intervistën me gojë.***
- Në të gjitha rastet ***mungon deklarata e paanësisë,*** të cilën duhet ta nënshkruajnë anëtarët e KPP, në fillim të procedurës së konkurrimit, për të deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim.

Në këto kushte, është detyrë e njësisë së burimeve njerëzore që në të ardhmen të kujdeset për plotësimin e të gjithë dokumentacionit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore që hartohen në një procedurë konkurrimi dhe ti administrojë ato në dosjet përkatëse të secilës procedurë.

### **III. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës.**

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, Komisioneri verifikoi përmbushjen e kërkesave ligjore të periudhës së provës, të përcaktuara nga neni 24, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; kreu VI, i Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar.

Për periudhën objekt mbikëqyrjeje, në Bashkinë Pogradec janë emëruar nëpunës civilë në periudhë prove, **14** punonjësit e evidentuar si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 59, datë 17.3.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm, në pozicionin “*Specialist finance*”, në Drejtorinë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar.
2. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 170, datë 02.8.2021, në pozicionin “*Specialist finance*”, në Drejtorinë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar.

3. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 170, datë 07.10.2022, në pozicionin “*Specialist për statistikën, asetet dhe menaxhimin e performancës*”, në Sektorin e administrimit të aseteve dhe statistikës.
4. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 84, datë 07.4.2021, në pozicionin “*Specialist për llogaritje rakordim për taksat*”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.
5. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 231, datë 15.9.2021, në pozicionin “*Specialist për trashëgiminë kulturore*”, në Sektorin e Trashëgimisë Kulturore (nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se punonjësja është emëruar nga lista e fituesve).
6. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 86, datë 07.4.2021, në pozicionin “*Specialist për zhvillimin e turizmit*”, në Sektorin e Turizmit dhe Rinisë.
7. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 88, datë 07.4.2021, në pozicionin “*Specialist për rininë*”, në Sektorin e Turizmit dhe Rinisë.
8. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 146, datë 18.06.2020, në pozicionin “*Specialist për Koordinimin e Integritit European*”.
9. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 185, datë 30.7.2020, në pozicionin “*Specialist jurist*”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.
10. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 48, datë 07.2.2020, në pozicionin “*Specialist jurist*”, në Drejtorinë e Juridike dhe Prokurimeve.
11. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 90, datë 03.5.2020, në pozicionin “*Specialist për prokurimet*”, në Drejtorinë e Juridike dhe Prokurimeve.
12. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 258, datë 13.10.2020, në pozicionin “*Specialist për artin pamor*”, në Sektorin e Turizmit dhe Rinisë.
13. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 147, datë 18.6.2020, në pozicionin “*Specialist për bashkëpronësinë*”, në Sektorin e Objekteve në Bashkëpronësi.
14. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 148, datë 18.6.2020, në pozicionin “*Specialist për bashkëpronësinë*”, në Sektorin e Objekteve në Bashkëpronësi.

Rezulton se, për të gjithë nëpunësit si më sipër, ka mbaruar periudha e provës, e cila, bazuar në përcaktimet e pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, zgjat një vit nga data e aktit të emërimit.

Konstatohet se, të gjithë nëpunësit kanë kryer ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA dhe në përfundim të tij janë vlerësuar me pikë, ku kanë marrë mbi 50% të pikëve. Nëpunësve iu është bërë vlerësimi i rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për vlerësimin e arritjeve vjetore. Periudha e provës është përfunduar me nxjerrjen e vendimit të konfirmimit si nëpunës civil për nëpunësit përkatës.

Nga verifikimi i mëtejshëm konstatohet se, në të gjitha rastet, procedurës së vendimmarrjes në fund të periudhës së provës, **nuk është caktuar nëpunësi civil më i vjetër në detyrë dhe, si rezultat, mungon mendimi me shkrim i tij**, udhëzimet e të cilit duhet të ndjekë nëpunësi civil në periudhë prove, si një element i rëndësishëm ligjor që shoqëron vendimmarrjen e eprorit direkt.

*(Për nëpunësit që kanë përfunduar periudhën e provës, të dhënat lidhur me: kryerjen e ciklit të trajnimit pranë ASPA-s; vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën e provës; si dhe, akti i konfirmimit si nëpunës civil, janë pasqyruar në Tabelën nr.1, që i bashkëlidhet raportit si pjesë e tij).*

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes rezulton se, **5** punonjës janë ende në periudhë prove, bëhet fjalë për:

1. \*\*\*\*\*<sub>1</sub>, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 222, datë 19.12.2022, në pozicionin “*Audit i brendshëm*”.
2. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 223, datë 19.12.2022, në pozicionin “*Audit i brendshëm*”
3. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 12, datë 13.1.2023, në pozicionin “*Specialist për Koordinimin e Integritimit European*”.
4. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 107, datë 07.11.2022, në pozicionin “*Specialist finance*”, në Drejtorinë Ekonomike dhe Menaxhimin Financiar.
5. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 194, datë 02.8.2021, në pozicionin “*Specialist finance*”, në Drejtorinë Ekonomike dhe Menaxhimin Financiar

**Konkluzion:** Nga sa analizuar më sipër, vlerësohet se, procedura e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës nga eprori direkt, duke i konfirmuar nëpunës civilë punonjësit e kësaj kategorie, është kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, përveç mungesës së një elementi, që është mendimi me shkrim i nëpunësit civil më të vjetër në detyrë.

Sipas pikës 2, neni 24, i ligjit, si dhe kreut VI, “*Periudha e provës*”, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në*

*katëgorinë ekzekutive*”, caktimi i nëpunësit civil më të vjetër në detyrë për të udhëzuar nëpunësin në periudhë prove, është një element i domosdoshëm, për orientimin e nëpunësit të ri në kryerjen e detyrës dhe që duhet të përfshihet në aktin e emërimit. Në përfundim, procedura e konfirmimit apo jo të nëpunësit civil, duhet të jetë e plotësuar me të gjithë elementët, përfshirë këtu mendimin me shkrim të nëpunësit më të vjetër civil në detyrë.

Kjo mangësi, është një parregullsi e eprorit direkt të nëpunësit në periudhë prove, i cili sipas pikës 4, kreu VI, të VKM-së, nuk ka caktuar nëpunësin më të vjetër në kujdestari por që nuk e cënon në thelb procesin e konfirmimit, si dhe marrëdhënien e punës të nëpunësve civilë të konfirmuar. Ajo vihet në dukje në këtë moment, për t’u patur parasysh në të ardhmen, që raste të tilla të mos përsëriten dhe procedura e konfirmimit apo jo të nëpunësit civil, të jetë e plotësuar me të gjithë elementët, sipas kërkesave të ligjit.

#### **IV. Plotësimi i vendeve të lira në katëgorinë e ulët apo të mesme drejtuese dhe respektimi i procedurave të kërkuara nga neni 26, i ligjit për nëpunësin civil.**

Bazuar në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të ligjit për nëpunësin civil, plotësimi i vendeve të lira në katëgorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë.

Rregullat që duhet të ndjekë njësia përgjegjëse për organizimin e procedurës së konkurrimit për këto raste, janë të parashikuara në nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil, në kreun II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në katëgorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, si dhe në kreun IV dhe V, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për katëgorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në katëgorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”.

Komisioneri verifikoi të gjitha veprimet procedurale të kryera nga institucioni dhe njësia përgjegjëse e tij, për plotësimin e vendeve të lira në katëgorinë e ulët dhe të mesme drejtuese me procedurën e ngritjes në detyrë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se, për periudhën Janar 2021 – Shtator 2023, janë realizuar **11** procedura konkurrimi për plotësimin e vendeve të lira në katëgorinë e ulët dhe të mesme drejtuese si më poshtë:

- **7** procedura janë realizuar nëpërmjet *ngritjes në detyrë* dhe

- 2 procedura janë realizuar nëpërmjet lëvizjes paralele
- 2 procedura janë realizuar nëpërmjet pranimin nga jashtë shërbimit civil

Konstatohet se, shpalljet e procedurave të konkurrimit, për periudhën objekt mbikëqyrjeje, janë bërë në portalin “Agjencia Kombëtare i Punësimit dhe Aftësive”, si dhe faqen e internetit të institucionit, sipas rregullave të përcaktuara në pikat 3 deri në 7, të kreut II, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, i ndryshuar.

- ✓ **Aspektet procedurale të procedurave të konkurrimit, lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë, për plotësimin e pozicioneve të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese.**

Rregullat procedurale të konkurrimit për të plotësuar pozicionet e punës në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues (*lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë*), janë të parashikuara në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe Vendimin nr.242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

Sipas përcaktimeve të mësipërme ligjore, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari, nga nëpunësit civil të së njëjtës kategori, nëpërmjet *procedurës së lëvizjes paralele*, e nëse me anën e kësaj procedure pozicionet e lira nuk plotësohen, atëherë vijon procedura për plotësimin e vendeve të lira me *procedurën e ngritjes në detyrë*.

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton se, për periudhën objekt mbikëqyrjeje, Janar 2021 - Shtator 2023, nga njësia përgjegjëse e institucionit të Bashkisë Pogradec, janë zhvilluar dhe kanë përfunduar me fitues **12** procedura konkurrimi për plotësimin e pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, nga këto:

- ❖ **7** procedura kanë përfunduar me procedurë ngritje në detyrë, nga punonjës pjesë e shërbimit civil brenda institucionit, bëhet fjalë për punonjësit e emëruar në këto pozicione pune:
  1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Bujqësisë dhe Trajtimit të Titujve të Pronësisë”;
  2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Asistencës Ligjore dhe Ankimeve Gjyqësore”, Drejtoria Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve;
  3. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Drejtor i Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë”;

4. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve”;
5. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Turizmit dhe Rinisë” në Drejtorinë e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë;
6. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Vlerësimit dhe Regjistrimit”, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore;
7. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Administrative”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Nga këqyrja e materialeve rezulton se, në të gjitha rastet e ngritjes në detyrë, nga kandidatë të brendshëm, kandidatët që kanë aplikuar për këtë procedurë, i plotësojnë kushtet minimale dhe kërkesat e veçanta sipas shpalljes për konkurrim, të përcaktuara në pikën 2, të kreut III, të aktit nënligjor, të cilat janë si më poshtë:

- ✓ Janë nëpunës civilë të konfirmuar, me kategori page sipas përcaktimit në shpallje, e vërtetuar në të gjitha rastet me aktet përkatëse të konfirmimit të statusit;
- ✓ Nuk kanë masë disiplinore në fuqi;
- ✓ Janë administruar vlerësimet e punës për periudhën e fundit, sipas formatit të vlerësimit, të nënshkruar nga nëpunësit pjesëmarrës në vlerësim.
- ✓ Gjithashtu, bazuar në planin vjetor të pranimit si dhe nevojat që kanë lindur gjatë vitit kalendarik, njësia përgjegjëse ka shpallur procedurat e konkurrimit për çdo pozicion, duke bërë të njohur edhe planin e zhvillimit të procedurës. Shpallja e procedurës së konkurrimit për secilin pozicion është bërë në portalin “AKPA” dhe në faqen e internetit të institucionit, sipas rregullave të përcaktuara në pikat 3 - 7, të kreut II, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, i ndryshuar.

Në vijim, mbështetur në pikën 4 dhe 6, të kreut III, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, konstatohet se, është respektuar në të gjitha rastet afati prej 35 ditësh kalendarike për shpalljen e procedurës së konkurrimit me ngritje në detyrë, si dhe afati prej 15 ditësh kalendarike për dorëzimin e dokumentacionit nga kandidatët e interesuar për këtë procedurë.

- ✓ Konkurrimi për procedurën e ngritjes në detyrë, sipas pikës 21, të kreut III, përfshin dy faza:
  - a) Verifikimin paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
  - b) vlerësimin e kandidatëve.

Njësia përgjegjëse (*Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënive me Jashtë*), në bazë të dokumentacionit të paraqitur, ka kryer verifikimin paraprak të aplikantëve me qëllim verifikimin nëse ata i plotësojnë ose jo kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpallje. Procedurat e verifikimit të kandidatëve janë kryer jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendrike nga data e mbylljes së pranimit të tyre, afat ky i parashikuar në pikën 22, të kreut III, të VKM nr. 242, dt. 18.3.2015.

Për çdo procedurë të realizuar, lista paraprake me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta të pozicionit të punës është shpallur në portalin “AKPA” dhe në faqen e internetit të institucionit. Në të gjitha rastet për këtë procedurë kanë aplikuar nëpunës të një kategorie paraardhëse të punësuar në administratën e bashkisë (nëpunës nga brenda institucionit të mbikëqyrur).

✓ *Vlerësimi i kandidatëve nga Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë (KPND)*

Për të realizuar fazën e dytë të konkurrimit, që është faza e vlerësimit të kandidatëve, mbështetur në parashikimet e pikës 6, të nenit 26, të ligjit për nëpunësin civil, njësia përgjegjëse ka ngritur Komitetin e Pranimit për Ngritje në Detyrë (KPND).

KPND është ngritur me 5 (pesë) anëtarë, është kryesuar nga njësia përgjegjëse dhe në përbërje ka patur një anëtar të zgjedhur nga titullari, midis nëpunësve civilë të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të institucionit, eprorin direkt të vendit të punës për të cilin është organizuar konkurrimi dhe dy ekspertë të fushës. Në caktimin e anëtarëve të këtij organi kolegjal janë mbajtur parasysh parashikimet e pikës 7, të kreut III, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, i ndryshuar dhe në të gjitha rastet KPND i ka marrë vendimet në praninë e të gjithë anëtarëve të tij.

Në testimin me shkrim dhe me gojë të kandidatëve, KPND ka bërë vlerësimin e kandidatëve:

- a) Jetëshkrimin, vlerësimi maksimal 20 pikë. (*Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e arsimit, përvojës e trajnimeve, të lidhura me fushën si dhe vlerësimin e arritjeve individuale në punë*).
- b) testimin me shkrim, vlerësimi maksimal 40 pikë;
- c) Intervistën e strukturuar me gojë, vlerësimi maksimal 40 pikë.

Për kryerjen e vlerësimit me shkrim të kandidatëve, anëtarët e KPND kanë përgatitur testet përkatëse. Në të gjitha rastet është hartuar çelësi i përgjigjeve, i cili nuk është nënshkruar nga anëtarët e KPND.

Testet përmbajnë pyetje me alternativa dhe me shtjellim. Pyetjet me alternativa janë hartuar sipas rregullave të përcaktuara në pikën 1, të ndarjes V/5, të udhëzimit të DAP, si

dhe brenda fushës së njohurive dhe aftësive, kompetencave, mbi të cilat do të zhvillohet testimi, të përfshira në shpalljen për konkurrim. Anëtarët e KPND kanë korrigjuar testet dhe kanë vlerësuar kandidatët duke dhënë pikët për secilin.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se, në vlerësimin me shkrim, anëtarët e KPND, kanë zbatuar rregullat e pikës 8, të paragrafit III/6, të udhëzimit të DAP, duke pjestuar shumën totale të pikëve me pesë *(në bazë të numrit të vlerësuesve)*. Në përfundim të këtij testimi, si dhe të *vlerësimit të jetëshkrimit (i cili është bërë sipas modelit të vlerësimit në Aneksin nr.7, bashkëlidhur udhëzimit të DAP)*, kanë rradhitur kandidaturat *(në rastet kur ka patur më shumë se një)*, të cilët janë kualifikuar për fazën e intervistës me gojë.

Në lidhje me *intervistën me gojë*, KPND, ka ndjekur këto hapa:

- Ka hartuar pyetjet që lidhen me njohuritë, aftësitë, eksperiencën që nevojiten për pozicionin e punës dhe që janë brenda fushës së testimit të publikuara në shpallje, të cilat janë të njëjta për të gjithë kandidatët.
- Brenda afateve të parashikuara, KPND ka zhvilluar intervistën me gojë me secilin nga kandidatët dhe më pas ka hartuar raportin e procedurës së zhvilluar duke bërë vlerësimin, i cili, sipas udhëzimit të DAP, është i njëjtë me atë të lëvizjes paralele, por shuma totale, në këtë rast, pjesëtohet me pesë *(numri i vlerësuesve)*.
- Në të gjitha rastet, kandidatët kanë nënshkruar deklaratat e mospranimit për të regjistruar intervistën me gojë.
- Rezulton që anëtarët e KPND, në të gjitha rastet, **nuk kanë firmosur** deklaratën e paanësisë, për të deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim.

Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, KPND ka hartuar raportin përfundimtar për rezultatin e konkurrimit.

Njësia e burimeve njerëzore, duke respektuar afatet që përcaktojnë aktet ligjore e nënligjore, ka shpallur fituesit në portalin “AKPA” dhe në faqen zyrtare të institucionit; njëkohësisht ka dalë edhe akti i emërimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Në të gjitha rastet konkurrenti fitues, në vlerësimin përfundimtar ka marrë më shumë se 70 pikë *(mbi 70% të pikëve)*. Raporti përfundimtar i vlerësimit dhe i gjithë dokumentacioni i fazës së vlerësimit i janë dorëzuar njësisë përgjegjëse e cila e ka administruar në mënyrë të rregullt këtë dokumentacion.

- ✓ Emri i kandidatit fitues është shpallur në portalin “AKPA”, në faqen e internetit të institucionit dhe në stendat e informimit të publikut.



✓ Njësia përgjegjëse ka përmbyllur procedurën e ngritjes në detyrë duke ftuar fituesin që të japë miratimin për pozicionin për të cilin ka konkurruar. Në të gjitha rastet kandidatët fitues kanë dhënë me shkrim miratimin e tyre se e pranojnë pozicionin e punës.

❖ 2 procedura kanë përfunduar me lëvizje paralele, nga punonjës pjesë e shërbimit civil, bëhet fjalë për punonjësit e emëruar në këto pozicione:

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës Sektori në Sektorin të Përfshirjes Sociale, Barazisë Gjinore dhe Mbrojtjes së Fëmijëve*”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale;
2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale*”.

❖ 2 procedura kanë përfunduar me konkurrim me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, bëhet fjalë për kandidatët fitues të emëruar në pozicionet:

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore*”
2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Turizimit, Muzeut dhe Trashëgimisë Kulturore*”, në Drejtorinë e Turizimit, Kulturës, Rinisë, Muzeut dhe Trashëgimisë Kulturore.

Ligji nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në pikën 4, të nenit 26, parashikohet se, procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese mund të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë, nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira. Në çdo rast plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.

Nëpërmjet këtij rregulli përjashtues, një numër i kufizuar pozicionesh të cilat normalisht do të ishin të hapura për konkurrim vetëm për nëpunësit civil, hapen edhe për kandidatë nga jashtë, nëse procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë rezultojnë pa fitues. Ky numër duhet specifikuar qartë në planin e rekrutimit.

Gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, për këto pozicione, nga njësia përgjegjëse e institucionit, në përgjithësi është bërë përpjekje për të përmbushur rregullat e përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” të ndryshuar, Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese*”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “*Për procesin e plotësimit të*

*vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në*

Në lidhje me procedurat e zhvilluara me kandidatë nga jashtë shërbimit civil konstatohet:

*Së pari*, sipas përcaktimeve në aktin ligjor e nënligjor, plotësimi i vendeve të lira të kategorisë së ulët e të mesme drejtuese, me kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, bëhet *me vendim të titullarit të institucionit*.

Në rastin konkret, nga verifikimi i mëtejshëm, rezulton se, procedurat e konkurrimit për pozicionet e mësipërme, janë përfshirë në planin vjetor të pranimeve në shërbimin civil, por konstatohet se, **nuk ka një akt të titullarit të institucionit, që përcakton plotësimin e vendit të punës edhe me kandidatë të tjerë** nga jashtë shërbimit civil që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lirë, për të cilën kemi folur edhe më sipër në material.

*Së dyti*, numri i vendeve të lira të kategorisë së ulët e të mesme drejtuese, që do të plotësohen me kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil *nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në çdo vit* kalendarik. Nga verifikimi rezulton se, numri i pozicioneve të punës që janë plotësuar me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, ***nuk e ka tejkaluar numrin sipas përcaktimeve të ligjit***.

Grupi i punës sjell në vëmendjen e njësisë përgjegjëse të Bashkisë Pogradec se, në vazhdimësi në të ardhmen, duhet të tregojë kujdes që në çdo rast anëtarët e Komitetit të Pranimin në Detyrë të firmosin deklaratën e paanësisë, duke deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim.

**Konkluzion:** Komisioneri konstaton se, procedurat e konkurrimit, të zhvilluara nëpërmjet lëvizjes paralele/ngritjes në detyrë/ pranim nga jashtë shërbimit civil, për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, janë zhvilluar në zbatim të rregullave të parashikuara në nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil, kreun III, të VKM nr.242, datë 18.3.2015 “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, si dhe kreun V, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”.

**V. Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese dhe respektimi i kërkesave të nenit 32, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar**

Procedurat e konkurrimit për pranimin në kategorinë e nivelit të lartë drejtues në institucionet e vetëqeverisjes vendore, organizohen në bazë të rregullave të parashikuara në nenin 32, të ligjit për nëpunësin civil dhe kreun III, VIII dhe IX, të VKM nr. 118, datë 5.3.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar.

Struktura dhe organika në fuqi e institucionit të Bashkisë Pogradec ka 1 (një) pozicion të kategorisë së lartë drejtuese, konkretisht pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, kategoria e pagës I-b.

Plotësimi i këtij pozicioni është parashikuar në planin vjetor të vitit 2021, 2022 dhe 2023. Nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, është bërë shpallja e procedurës së konkurrimit në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen zyrtare të institucionit.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, ky pozicion pune është plotësuar me procedurën e pranimin në kategorinë e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, konkurrimit të hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, të parashikuar nga shkronja “b”, pika 1, kreu VIII, të VKM nr. 118, datë. 5.3.2014, i ndryshuar.

Konstatohet se, procedura e konkurrimit **nuk është paraprirë nga një vendim i titullarit** (në këtë rast i Kryetarit të Bashkisë) që kjo procedurë të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil. Por në shpalljen e publikuar për pozicionin në fjalë, e cila është materializuar me shkresën nr. 2253 prot., datë 01.06.2023, të Kryetarit të Bashkisë, është përcaktuar se, procedura është e hapur për nëpunësit civilë të konfirmuar në kategorinë e mesme drejtuese të shërbimit civil dhe nëse nuk paraqiten kandidatë të tillë, procedura do të vijojë me kandidatë jashtë shërbimit civil, të cilët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në këtë kategori.

Nga verifikimi i mëtejshëm rezulton se, në përmbajtjen e shpalljeve për konkurrim, janë përfshirë të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 6, të kreut VIII, të VKM nr. 118, datë 5.3.2014, i ndryshuar.

Në vijim, duke qenë se nuk është ofruar asnjë kandidat i përshtatshëm që të plotësojë kërkesat e përgjithshme e të posaçme për këtë pozicion pune, konstatohet se ky pozicion, është plotësuar me procedurën e pranimin në kategorinë e nëpunësve civilë të nivelit të

lartë drejtues, nëpërmjet konkurrimit të hapur edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, por pa një vendim të titullarit të institucionit.

➤ *Faza e parë e konkurrimit*

Kjo procedurë, është shpallur në datën 01.6.2023, në portalin “*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*” dhe në faqen zyrtare të institucionit, ashtu si e kërkon ligji, në zbatim të parimit të transparencës së procesit dhe barazisë së kandidatëve.

Në shpalljen e vendit të lirë, është përcaktuar se kjo procedurë është e hapur për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese, si dhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori.

Nga verifikimi i mëtejshëm rezulton se, në përmbajtjen e shpalljes për konkurrim, janë përfshirë të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 6, të Kreut VIII, të VKM nr. 118, datë 5.3.2014, i ndryshuar. Por konstatohet se nuk është respektuar afati kohor prej 60 ditësh që parashikon pika 4, e Kreut VIII, e aktit nënligjor, pasi shpallja e pozicionit të lirë është bërë në 01.6.2023, ndërsa konkurrimi është zhvilluar në datën 03.7.2023.

Për këtë procedurë konkurrimi ka dorëzuar dokumentet 1 kandidat, për të cilin njësia e burimeve njerëzore ka bërë verifikimin paraprak, nëse kandidati i plotëson kriteret specifike për pozicionin. Në përfundim të verifikimit paraprak ka kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit, kandidatin e vetëm, Dritan Babasuli, duke e shpallur në portalin “*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*”, si dhe në faqen zyrtare të institucionit.

Më tej, njësia e burimeve njerëzore, ka bërë publikimin e verifikimit përfundimtar në portalin “*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*” dhe në faqen zyrtare të institucionit, duke njoftuar datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet konkurrimi.

➤ *Faza e dytë e konkurrimit*

Pasi ka përfunduar faza e parë e konkurrimit, është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP) për vlerësimin e kandidatit nëse plotësonte kushtet e pranimit në kategorinë e nivelit të lartë drejtues, për pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”.

KPP-ja ka organizuar testimin me shkrim dhe me gojë të kandidatit dhe ka realizuar vlerësimin e tij sipas përcaktimeve:

- a) Vlerësimi i jetëshkrimit (CV), vlerësimi maksimal 10 pikë (*Vlerësimi i jetëshkrimit përfshin vlerësimin e arsimit, eksperiencës dhe trajnimeve, të lidhura me fushën si dhe vlerësimin e arritjeve vjetore*).
- b) Testimi me shkrim, vlerësimi maksimal 40 pikë;
- c) Intervistë e strukturuar me gojë, vlerësimi maksimal 50 pikë.

Për realizimin e vlerësimit të kandidatit, komisioni i pranimit ka hartuar pyetjet e vlerësimit me shkrim dhe pyetjet e vlerësimit me gojë. Pyetjet janë hartuar duke patur në konsideratë fushën e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Secili nga anëtarët e KPP ka vlerësuar çdo pyetje me pikë. Intervista me gojë është zhvilluar menjëherë pas përfundimit të korrigjimit të testimit me shkrim.

Në përfundim të vlerësimit, sipas raportit përfundimtar datë **03.7.2023**, të KPP, shpallur kandidati **\*\*\*\*\***, ka grumbulluar 82.9 pikë. Të gjitha materialet i janë dorëzuar njësisë së burimeve njerëzore. Sipas akteve të vëna në dispozicion të grupit të punës, akti i emërimit ka dalë në datën **6.7.2023**.

- **\*\*\*\*\***, me aktin nr. 09 prot., datë 06.7.2023, të Burimeve Njerëzore, emërohet në pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”, në Bashkinë Pogradec.

**Konkluzion:** Procedura e konkurrimit për pranimin nga jashtë shërbimit civil, në kategorinë e nivelit të lartë drejtues, për pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”, përgjithësisht është organizuar në bazë të rregullave të parashikuara në nenin 32, të ligjit për nëpunësin civil, si dhe kreun III, VIII dhe IX, të VKM nr. 118, datë 5.3.2014 “*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së*”, i ndryshuar.

Sjellim në vëmendje të institucionit që, në rastet e plotësimit të pozicioneve të kategorisë së nivelit të lartë drejtues, me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, titullari me një akt si organi vendimmarrës, duhet të vendosë nëse procedura e pranimit do të jetë e hapur edhe për kandidatët e tjerë, jashtë shërbimit civil, kur këta të fundit plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, e shprehur kjo edhe në nenin 32, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

**Konkluzion:** Duke qenë se, mangësia e evidentuar gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”, nuk është e asaj natyre që të sjellë paligjshmërinë apo pavlefshmërinë absolute të procedurës së konkurrimit, sjellim në vëmendje të titullarit të institucionit dhe njësisë përgjegjëse, që në të ardhmen të tregohet kujdes që kjo parregullsi të mos përsëritet.

### Dosja e personelit

Gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucion në lidhje me zbatimin e kërkesave të ligjit për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, u konstatua se, dokumentacioni i verifikuar, në këtë rast, administrohet edhe në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil.

Të dhënat, të cilat kanë të bëjnë me përvojën në punë, fillimin e marrëdhënieve të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*), diplomën e arsimit të lartë që kërkon pozicioni i punës (*nivelin e diplomës dhe fushën e studimeve univeristare*), si dhe plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, janë paraqitur në Tabelën nr.1 dhe 2, bashkëlidhur raportit.

Nga këto të dhëna rezulton se, në institucionin e Bashkisë Pogradec, në momentin e mbikëqyrjes janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil 78 punonjës, moshë mesatare e nëpunësve është 34 vjeç, ku, 48 punonjës janë femra dhe 30 punonjës janë meshkuj.

Përsa i përket arsimit, konstatohet se, 68 nëpunës kanë kryer arsimin e lartë në institucione arsimore publike; 5 nëpunës kanë kryer arsimin e lartë në institucione arsimore private; 5 nëpunës e kanë kryer arsimin e lartë në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit. Diplomat në këtë rast janë të njehsuara nga Ministria e Arsimit, i cili është institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave.

**Konkluzion:** Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se dosjet e personelit janë të rregullta, të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore, që është edhe njësi përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore për institucionin.

\*  
\*     \*

Këto ishin rrethanat e konstatuara nga Komisioneri gjatë procesit të mbikëqyrjes në Bashkinë Pogradec, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësi përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, e në vijim.

Aktet administrative që dokumentojnë procesin e mbikëqyrjes në këtë institucion, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat si më poshtë:

- *Tabela nr.1: “Nëpunës të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, në Bashkinë Pogradec”;*
- *Tabela nr.2: “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes, janë të emëruar në pozicione të shërbimit civil”.*

Këto ish-in rrethanat e konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin Bashkia Pogradec, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia e burimeve njerëzore e institucionit dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e organizimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimin në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për punonjësit e punësuar në institucion në momentin e mbikëqyrjes.

Njësia e burimeve njerëzore e institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrë masat për të realizuar detyrat e lëna nga Komisioneri në vendimin e paralajmërimit, brenda afatit të vendosur në vendim, për të rregulluar situatën e administrimit të shërbimit civil në institucion.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**